



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:156294  
Datë: 28.05.2024  
Numri i dokumentit: 05742568

K.DH.SH.II.nr.407/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Shpk “Blue Plan Kosovo AG” me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyra e Avokatëve “Hodaj & Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.71/22 të datës 06.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditësit, Sh.p.k “Blue Plan Kosovo AG” me seli në Prizren, e datës 24.01.2024, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.71/22 të datës 06.12.2023, **Vërtetohet**.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e ankimuar të Dhomës së Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, nën pikën I. të dispozitivit, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, Sh.p.k “Blue Plan Kosovo AG” me seli në Prizren. Nën pikën II. mbetet në fuqi vendimi nr.312/2020 i datës 20.05.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë. Nën pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, për shkak të shkeljes esenciale me rëndësi absolute të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit “Blue Plan Kosovo AG” Sh.p.k me seli në fshatin Vërmicë Komuna e Prizrenit, të ndryshohet aktgjykimi KF.nr.71/22 i datës 06.12.2023 i nxjerrë nga Gjykata Komerciale e Kosovës-Divizioni Fiskal në atë mënyrë që për çështjen të vendoset si në vijim, të aprohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Blue Plan Kosovo Ag” Sh.p.k me seli në fshatin Vërmicë Komuna e Prizrenit, ashtu që të anulohen Njoftim vlerësimi i tatimit shtesë të ATK-së i datës 31.08.2020, vendimi nr.312/2020 i nxjerrë me datë 05.11.2020 nga ATK-Departamenti i Ankesave, Njoftim Vlerësimi i kontrollit pa numër i datës 15.03.2021 dhe vendimi nr.124/2021 i nxjerrë me datë 20.05.2021 nga ATK-Departamenti i Ankesave, Detyrohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës që në afat prej 30 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ti ndryshojë Njoftim Vlerësimin e tatimit shtesë ATK-së i datës 31.08.2020, vendimi nr.312/2020 i nxjerrë me datë 05.11.2020 nga ATK-Departamenti i Ankesave, Njoftim vlerësimi i kontrollit pa numër i datës 15.03.2021 dhe vendimi nr.124/2021 i nxjerrë me datë 20.05.2021 nga ATK-Departamenti i Ankesave si dhe të njihen të ligjshme 23 faturat e blerjes, ose të anulohet Aktgjykimi me numër KF.nr.71/22 i datës 06.12.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Departamenti Fiskal dhe çështja ti kthehet të njejtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura ATK ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën e kundërshton ankesën në tërësi si të pa bazuar duke theksuar se Gjykata e Shkallës së Parë ka konstatuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike duke refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit “Blue Plan Kosovo Ag” me NUI 810020610, duke lënë në fuqi vendimin me nr.312/2020 të datës 05.11.2020 dhe nr.124/2021 të datës 20.05.2021 të ATK-së, më tej ka propozuar që Dhoma e Shkallës së Dytë të nxjerrë aktgjykim me të cilin refuzohet ankesa e paditësit “Blue Plan Kosovo Ag” si e pa bazuar në tërësi, të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.71/2022 datë 06.12.2023 dhe të mbetet në fuqi vendimi i DA nr.312/2020 i datës 05.11.2020 dhe nr.124/2021 i datës 20.05.2021 të ATK-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për

Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me vendimin nr.312/2020 të datës 05.11.2020, në pikën I. të dispozitivit është refuzuar si e pa bazë ankesa nr.312/2020 e datës 28.09.2020 e subjektit “Blue Plan Kosovo-Ag” Shpk me numër fiskal NUI 810020610 me pranor F.P., me seli të biznesit në adresën Rr. Ulqini nr.144- Prizren në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 “Për Procedurën Administrative” në lidhje me nenin 89, paragrafin 2 të Ligjit nr.03/L-2222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Nën pikën II, Procedura e ankesës nuk ndërprejnë obligimin e tatimpaguesit për pagesën e detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkime, interes) në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin Plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Ndërsa me vendimin nr.124/2021 të datës 20.05.2021 nën pikën I. është refuzuar ankesa nr.124/2021 e datës 13.04.2021 e subjektit “Blue Plan Kosovo-Ag” Shpk me numër fiskal NUI 810020610 me pronar F.P., me seli të biznesit në adresën Rr. Ulqini nr.144- Prizren në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 “Për Procedurën Administrative” në lidhje me nenin 89, paragrafin 2 të Ligjit nr.03/L-2222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe Njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë nga ri kontrolli vërtetohen si të bazuara. Nën pikën II. Procedura e ankesës nuk ndërprejnë obligimin e tatimpaguesit për pagesën e detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkime, interes) në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin Plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

I pakënaqur me vendimet e ATK-së, paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ushtron padi në Gjykatë, në procedurë të konfliktit administrativ. Dhoma e Shkallës së Parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të datës 06.12.2023, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ndërsa e lenë në fuqi vendimin e organit të paditur, me arsyetim se: Nga ekzaminimi i vendimeve kontestuese nr.312/2020 i datës

05.11.2020 dhe nr.124/2021 i datës 20.05.2021, Gjykata konstaton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës ka refuzuar si të pa bazuara ankesat e subjektit në procedurë, me arsyetim se kontrolli këtë vendosje-vlerësim e ka mbështetur në nenin 14, 15 dhe 19 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Tutje ka konstatuar se Divizioni i Ankesave sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, vërteton se faturat e realizuara me biznesin “Batatina BB” nuk pranohen sipas nenit 38 të Ligjit dhe nenit 58 par.2 të Udhëzimit Administrativ nr.03/2015, dispozitë që parasheh *“Personi i tatueshëm i cili ka pranuar një faturë për një furnizim malli apo shërbimi, i cili në fakt nuk ka ndodhur (transaksion fiktiv), TVSH-ja edhe pse mund të jetë paguar nga personi, nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e shënuar në atë faturë”*. Po ashtu ka theksuar se në rastin konkret Divizioni i Ankesave vërteton se tatimpaguesi nuk ka bërë pagesa përmes bankës e cila është e rregulluar me dispozita ligjore të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat përkatësisht nenin 13 par.7. Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit në seancë të datës 23.03.2023 ka lejuar dëgjimin e dëshmitarëve në seancën e radhës në këtë kontekst tregtar administrativ me dëshmitarët N.B.. me nr. Identifikues 0634 Inspektor Tatimor nga Drejtoria Rajonale Prizreni 2; dhe Gazmend Gjocaj. me nr. Identifikues 0576 Inspektor Tatimor nga Drejtoria Operative Rajonale Prishtina 2, ndërsa për dëgjimin e dëshmitarit Bilall Dragusha, Gjykata sipas propozimit të të autorizuarit të palës së paditur përmes aktvendimit në seancë të datës 22.05.2023 ka lejuar dëgjimin e këtij dëshmitari për seancën e radhës. Gjykata në seancën e datës 20.04.2023 ka bërë edhe dëgjimin e dëshmitarit Gazmend Gjocaj i cili ka deklaruar se: *“Gjatë verifikimit të dokumentacionit kontabël nuk kemi pasur ndonjë dëshmi shtesë apo dokumentacion kontabël shtesë nga kontrolli paraprak, përveç disa ndryshimeve minimale jo substanciale. Në autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, është cekur se iniciativa për ri-kontroll është bërë nga DHTI-ja në ATK, dhe shkruan që duhet të bëhet analizë financiare e rrjedhës së keshit, për shkak të dyshimeve të transaksioneve të pa ndodhura (fiktive), me subjektin tjetër tatimor “Batatina BB” sh.p.k., nga i cili ky subjekt ka pasur transaksione të blerjes sipas faturave dhe kartelave financiare dhe deklarimeve në ATK. Bazuar në këto, gjatë procedurës së rikontrollit për këtu paditësin është hapur procedurë e kontrollit me rekomandime nga DHTI në ATK edhe ndaj subjektit “Batatina BB” sh.p.k, me NUI:810139114, dhe të njëjtit subjekt me rekomandim nga DHTI-ja i janë anuluar shitjet për subjektin, këtu paditësin, dhe bazuar në Raportin e Kontrollit për subjektin “Batatina BB” sh.p.k, të cilit siç thamë i janë*

anuluar shitjet nga ATK, përkatësisht për subjektin, këtu paditësin, në të njëjtat transaksione të blerjes nuk i kemi pranuar si blerje për shkak se të njëjtat janë anuluar nga Regjioni Prishtina 1, dhe për këtë arsye transaksionet e blerjes, apo kostoja e subjektit në fjalë, këtu paditësit nuk është pranuar nga ana jonë sipas Raportit të Kontrollit. Andaj, për këtë arsye nuk kemi pasur arsye që të bëjmë analizë të rrjedhjes së keshit, pasi që ne i kemi anuluar koston e objektit sipas faturave blerëse, dhe për këtë arsye ka rrjedhë edhe tatimi shtesë tek subjekti në fjalë, këtu paditësi. Po ashtu, gjykata në seancën e datës 22.05.2023 ka bërë dëgjimin e dëshmitarit N.B., i cili ka deklaruar se lidhur me faturat dhe specifikacionet, me të njëjtat nuk ka njoftuar Prishtina 1. Është bërë analiza e rrjedhjes së Keshit dhe nga kjo analizë kemi këto rezultate, që këtu paditësi nuk posedon pagesa- transaksione me biznesin “Batatina BB” Shpk, ndërsa për subjektin tjetër “Lake Side” nuk mund të përgjigjem ngase nuk e kam pasur në kontroll. Kemi bërë analizë dhe ka rezultuar që blerjet e paditësit nga biznesi “Batatina BB” për rezultat të kontrollit kanë qenë fiktive. Sepse gjitha investimet deri në realizimin e blerjeve të këtu paditësit nga subjekti “Batatina BB” për periudhën 01-02/2020, kanë qenë blerje për të cilat këto investime janë kryer më herët nga subjekte të tjera nga rregjoni i Prizrenit. Faturat blerëse nga subjekti Batatina BB kanë përmbajtje që këto punime janë kryer më herët siç janë gërmimi i dheut, ndërtimi i vrazhdët, thuajse 80%-90% janë kryer investimet nga bizneset nga Regjioni i Prizrenit për procesin e kontrollit nuk ka rëndësi deklarimi në EDI sistem i blerjeve ose shitjeve, sa ka rëndësi prezantimi fizik i faturës, mirëpo për neve këto kanë qenë fiktive, pasi që këto janë lëshuar me 01-02/2020 nga “Batatina BB” Shpk, me përmbajtje investimet paraprake, për të cilat i kanë kryer bizneset tjera, nga të cilat biznesi Blue Plan Kosova AG nga 05/2018 deri 08/2019 ka pranuar 3 rimbursime nga ATK në bazë të faturimeve nga bizneset e regjionit të Prizrenit konform të gjitha dispozitave dhe rregullave të ATK-së, përfshirë përmbajtjen e faturës, analizuar me projektin dhe parametat që janë prezantuar dhe pagesave në llogarinë bankare të biznesit “Blue Plan Kosova AG” Shpk”. Gjykata në seancën e datës 14.06.2023 ka bërë edhe dëgjimin e dëshmitarit Bilall Dragusha Inspektor i lartë për hetime tatimore në ATK-ë, i cili ka përveç tjerash ka deklaruar se: Lake Side AG Prizren, pastaj Blue Plan Kosova AG Prizren dhe RKS Invest AG janë tri subjekte që pronar drejtor kanë z.F.P.. Pas vendimit të drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, shënimet janë bartur nga drejtorja rajonale Prishtina 1, ku ata fillimisht kanë realizuar vizita tek subjekti Batatina BB Shpk me seli në Prishtinë, si rast i ndërlidhur me këto biznese. Ne kemi filluar ta trajtojmë rastin dhe kemi vërejtur se kemi të bëjmë më dyshimin e një skeme të përgatitur të mashtrimit tatimor përmes transaksioneve të pavërteta ekonomike apo transaksione fiktive me qëllim të krijimit të një balance të rrejshme

kreditore në kategorinë e TVSH-së dhe më pas aplikimin e kërkesës së rimbursimit të këtyre mjeteve në vlerë të përafërt prej 300,000.00 euro. Tutje ky dëshmitar ka theksuar se: Batatina BB Shpk nuk ka mundur të sjell asnjë dëshmi se ka kryer ndonjëherë ndonjë punë ndërtimore, pronari i saj jeton jashtë Kosove, ndërsa Bedri Batatina BB si person i autorizuar i kompanisë është marrë me shitje të pemëve dhe perimeve, dhe gjatë verifikimit të llogarive tatimore dhe shënimeve të tjera zyrtare i njëjti edhe para se të kontaktoj me z.F.P. ka shitur rregullisht fatura me përmbajtje të pa vërtetë ekonomike për biznese të ndryshme dhe persona të ndryshëm, për të cilat nuk ka pasur mbulesë furnizimi. Gjykata ua ka falur besimin e plotë deklaratave të dëshmitarëve të lartcekur, meqë të njëjtat janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me shkresat e lëndës në bazë të cilave edhe gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike, dhe rrjedhimisht ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.71/22 të datës 14.06.2023 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontekst tregtar administrativ me ekspertin financiar Bali Morina, dhe me detyra përkatëse. Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 25.08.2023 dhe sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 06.12.2023, nga ana e ekspertit financiar B.M.1, për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi profesional ku i njëjti ka konstatuar se: Faturat e transaksionit (23 fatura) në mes të subjekteve "Blue Plan Kosovo AG "Shpk. si blerës dhe "Batatina BB" Shpk, si furnitor, nuk e kanë përmbajtjen e duhur, ngase faturat nuk kanë përshkrim adekuat të furnizimit me material – mall. Vlera financiare e faturave (23 fatura) është 15,328,978.10 €, dhe kjo vlerë përputhet me regjistrimin në librin e blerjes së blerësit (furnitor "Batatina BB " Shpk dhe blerësit "Blue Plan Kosovo AG"Shpk). Ndërsa vlera e faturave shitëse nga "Blue Plan Kosovo AG" Shpk, është 15,483,816.85€, që njëherit është edhe vlera financiare e Paramasave dhe Parallogarive e projektit në ndërtimin e Hotel "Lakeside" në Vërmicë me sipërfaqe prej 15210,00m<sup>2</sup>. Vlerat e Para llogarive financiare në praktikë i rregullon mekanizmi i tregut. Faturat janë të deklaruara në deklaratat e TVSH për periudhat e faturimit, dhe si të tilla kanë krijuar obligime për pagesë. Mjetet financiare për Faturat e furnitorit "Batatina BB" Shpk, nuk ka dëshmi në lëndën KF.nr.71/22 se janë transferuar në llogari bankare. Kontraktuesi kryesor "Blue Plan Kosovo AG" Shpk, ka të nënshkruar kontratë me nënkontraktuesin -"Batatina BB" Shpk, me datë 15.04.2019 në të cilën neni II i kontratës përcakton afatin e pagesave. Subjekti "BluePlan Kosovo AG" dhe "Batatina BB ", në bazë të dokumentacionit për ekzaminim ka të krijuara marrëdhënie

debitore - kreditore si ndërlidhje për kryerjen e punëve në bazë të kontratës së datës 15.04.2019 në vlerë prej 18,270,000.00€, marrëveshje mes palëve. Subjekti "Batatina BB" që i ka lëshuar faturat për subjektin "Blue Plan Kosovo AG" Shpk, nuk ka punëtor të regjistruar e as pagesë tatimi në të ardhura personale. Fakt është Lista e Pagave për Kompaninë "Batatina BB" Shpk, në lëndën KF.nr.71/22 e lëshuar nga ATK, datë 19.05.2021 për vitin 2018, 2019 dhe 2020. Nga e paditura janë lëshuar 3 Raporte kontrolli për paditësin dhe atë: 1. ATK-Drejtoria Rajonale Prizreni 2, Nr. i dosjes 15258, datë 31.08.2020, 2. ATK-Raport RI-Kontrolli - Drejtoria Drejtoria Operative Rajonale-Prishtina 2, dt.15.03.2021 dhe 3. ATK-Raport i Ri kontrollit - Drejtoria Rajonale Prizreni 2, date 21.10.2021. Raportet e kontrollit, Ri-Kontrollit të shënuara, janë për të njëjtat lloje të tatimeve dhe për të njëjtat periudha tatimore. Të gjeturat janë: Faturat e furnitorit "Batatina BB" Shpk për blerësin "Blue Plan Kosovo AG" Shpk., nuk kanë kaluar përmes sistemit bankar si obligim në mes Debitorit dhe Kreditorit (faturat nga nr.001 deri te nr. ren 023/2020 ). Furnitori "Batatina BB", nuk ka punëtorë të regjistruar, nuk ka pagesa të tatimeve dhe kontributeve e as pagese të të ardhurave personale. Faturat e shitjes (23 fatura) të lëshuara nga biznesi "Batatina BB" për biznesin "Blue Plan Kosovo AG" Shpk janë anuluar nga kontrolli i kryer nga Drejtoria Rajonale Prishtina 1 për vitin 2020. Tatimi Shtesë për operatorin "Blu Plan Kosovo AG" Shpk, ka rrjedhë si rezultat i eliminimit të faturave të blerjeve investive të realizuara me subjektin "Batatina BB", për periudhën 01/2020 dhe 02/2020 të deklaruara në llojin e tatimit në TVSH. Eliminimi i faturave është me rekomandim të departamentit, DHTI-së dhe ATK-së - Kontrolli Prishtina 1. Raporti i R-Kontrollit, i dt.21.10.2021, Njësia DHTI. Nr. Prot.459/21, largon blerje nga gjendja e deklarimeve tatimore të biznesit "Blue Plan Kosovo AG" Shpk, i 23 faturave tatimore të blerjes nga biznesi "Batatina BB" për periudhën 01 dhe 02/2020 prej 15,328,978.69 €, TVSH 2,759,216.15€. Zvogëlimi i shitjeve nga gjendja e deklarimeve nga "Blue Plan Kosovo AG" Shpk në periudhën 01 dhe 02/2020 në vlerë 15,483,816.85€, TVSH 2,787,087.03 €. Raporti i dytë i Kontrollit është bërë në bazë të Vendimit mbi emërimin e Komisionit "AD HOC " për kryerjen e kontrollit të subjekti tatimor "Blue Plan Kosovo AG" Sh.p.k, sipas referencës ZDP 72/2020, Nr. Prot.04-06-3714 datë 10.11.2020. Vendimi është nënshkruar nga zv. Drejtori i Përgjithshëm - Operacioni. Mendoj se me heqjen e faturave furnizuese nga biznes "Batatina BB" Shpk, hiqen gjegjësisht zvogëlohen edhe shitjet e deklaruara nga biznesi "Blue Plan Kosovo AG" Shpk. Subjekti ekonomik "Blue Plan Kosovo AG" Shpk, sipas gjendjes së borxheve në sistemin SIGTAS në ATK, nuk ka obligime. Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të ekspertit B.M.1, në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat e caktuara me

aktvendimin e lartcekur. Gjykata i vlerësoj të pa bazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me të gjeturat e ekspertit financiar, deklaratat e dëshmitarëve, si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se aktvendimet e kontestuar janë të qartë dhe të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë kontest tregtar administrativ, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi ankimor nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative të cilat kolegji i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së, dhe as me shkelje, sipas pretendimeve në ankesë të dispozitave ligjore dhe të Ligjit për ATK. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-vendimit të ankimuar nga paditësi mbështetur edhe në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) e të cilin aktvendim në procedurë administrative, e gjithashtu sipas aktgjykimit të ankimuar, edhe në procedurë gjyqësore në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike e çështjes në shqyrtim, për arsye se paditësi nuk ka deklaruar qarkullimin real lidhur me periudhat e kontrollit, nuk ka bërë pagesa përmes bankës, nuk ka fatura të blerjes e ku është konstatuar nga eksperti se 23 faturat të cilat janë kontestuese në këtë proces, pra në këto fatura nuk janë specifikuar detaje për çfarë janë përdorur blerjet e materialit ndërtimor, shërbimet nuk kanë çmime dhe faturat nuk janë thirrur në nenin 45 të Ligjit nr. 05/L037 për TVSH-ë dhe nuk ka dëshmi se këto fatura janë realizuar përmes llogarisë bankare ashtu siç e parasheh legjislacioni tatimor respektivisht neni 13 par. 7 të Ligjit 03/L-222 për ATK. Dhoma e Shkallës së Parë nga deklaratat e dëshmitarëve e po ashtu është vërtetuar edhe nga ekspertiza financiare se paditësi përveç që nuk ka pasur transaksione bankare për faturat e lëshuara nga subjekti Batatina BB për këtu paditësin, faturimi nga biznesi “Batatina BB” dhe këtu paditësi kanë fatura të njëjta, pra me elemente përmbajtjesore identike në numra sikurse faturat e këtu paditësit me subjektin tjetër Lake Side AG. ATK e ka trajtuar si qarkullim shtesë dhe kontrolli këtë konstatim e ka mbështetur në nenin 14,15 dhe 19 të ligjit nr. 03/L-222 për



Administratën Tatimore dhe Procedurat. Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka konstatuar se e paditura drejtë ka vepruar kur paditësin e ka ngarkuar me qarkullim dhe tatim shtesë, pasi që paditësi nuk ka deklaruar obligimin tatimor të përcaktuar me ligj.

Sa i përket pretendimeve ankimore në ankesë se gjykata është përfshirë në shkelje procedurale nga neni 8 i LPK-së i zbatueshëm sipas nenit 63 të ligjit për Konfliktet Administrative pasi që nuk i ka vlerësuar dhe analizuar me kujdes çdo provë në këtë çështje juridike për shkak se nga provat e administruara ka nxjerr konstatime të pa qarta të gabuara kontradiktore e në kundërtënie me shkresat e lëndës për shkak të cilave aktgjykimi i ankimuar nuk mund të ekzaminohet. Si rrjedhojë e mos vlerësimit të drejtë të provave ka ardhur deri të konstatimi i gabuar i fakteve vendimtare në këtë çështje juridike, pastaj deri të dhënia e arsyeve të paqarta dhe kontradiktore si dhe dhënia e arsyeve në kundërshtim me provat dhe shkresat e lëndës. Kolegji këto pretendime i vlerësoj se nuk qëndrojnë, pasi që aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka dëgjuar dëshmitarët e propozuar, po ashtu ka nxjerrë edhe ekspertizë financiare, andaj ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve se gjykata me aktgjykimin e ankimuar nuk ka bërë konstatim të plotë të gjendjes faktike, sepse e njëjta ka nxjerr konstatime të cilat janë në kundërshtim me vet përmbajtjen e provave dhe deklaratave. Po ashtu pretendimi se gjykata ka dështuar në arritjen e një konkluzioni të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike e i cili është element kyç për vendimmarrjen e drejtë në një proces gjyqësor. Kjo shkelje bazohet në mungesën e një analize të plotë dhe të detajuar të të gjithë provave të disponueshme dhe në një vlerësim të mangët të tyre në lidhje me çështjen në fjalë. Gjykata ka ndërmarr një qasje të gabuar duke i lidhur ngushtë çështjen e kontestimit të 23 faturave me aktivitetet tatimore të “Batatina BB”, duke i dhënë këtij të fundit një rëndësi të tepruar në këtë shqyrtim gjyqësor. Ky qëndrim i gjykatës siç shihet në arsyetimin e saj, duket të ketë lënë pa marrë në konsideratë faktin se sjelljet tatimore të “Batatina BB” duhet të trajtohen veçmas dhe nuk duhet të ndikojnë në mënyrë të pa drejtë në vendimin përfundimtar të gjykatës në lidhje me paditësi. Dhoma e Shkallës së Dytë këto pretendime nuk i aprovoj pasi që vërtetoi se paditësi “Blue Plan

Kosovo Ag” Shpk me seli në Prizren dhe subjekti “Batatina BB” Shpk me seli në Podujevë kanë krijuar mardhënie debitorë-kreditore në bazë të kontratës së datës 15.04.2019 në vlerë prej 18,270,000.00€, për kryerjen e punëve, faturat nga nr.001 deri te nr. 023/2020 të lëshuara nga subjekti “Batatina BB” Shpk, për subjektin “Blue Plan Kosovo Ag” Shpk nuk kanë kaluar përmes sistemit bankar si obligim në mes debitorit dhe kreditorit. Kolegji gjen se nga 23 faturat e lëshuara nga biznesi "Batatina BB" për biznesin "Blue Plan Koosvo AG" Shpk janë anuluar nga kontrolli i kryer nga Drejtoria Rajonale Prishtina 1 për vitin 2020. Andaj, kolegji vlerëson se e paditura me të drejtë e ka ngarkuar paditësin “Blue Plan Kosovo Ag” Shpk me seli në Prizren, me tatim shtesë për shkak të eliminimit të këtyre faturave të blerjeve investive të realizuara me subjektin "Batatina BB", për periudhën 01/2020 dhe 02/2020 të deklaruara në llojin e tatimit në TVSH.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.407/24, me datë 24.05.2024

Numri i lëndës: 2021:156294  
Datë: 28.05.2024  
Numri i dokumentit: 05742568

Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri